



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 706/ 10 prot.

Datë 25/03/2026

V E N D I M
Nr. 424/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 25/03/2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 392/2026, datë 12.03.2026 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “*Blerje materiale hidrulike, tubo, pvc, pe, Corrogete*”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Alpha Solutions Group*” SHPK me NIPT L63620402U me adresë Lagjia “29 Mars”, Nr. Pas 15-339, Patos, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.
Adresa: Rruga “Gurasit” Pogradec.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 392/2026, datë 30.10.2025, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Alpha Solutions Group” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.*
 - 2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alpha Solutions Group” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.*
 - 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 - 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimes “Alpha Solutions Group” SHPK.*
 - 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 262 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën nr. 706/7 prot., datë 18.03.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 392/2026, datë 12.03.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “*Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete*”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka hartuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga verifikimi i së cilës konstatohet se ky i fundit ka modifikuar dhe publikuar ndryshimet në shtojcë sipas përcaktimeve të bëra në vendimin KPP Nr. 392/2026, datë 12.03.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 262 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën nr. 706/7 prot., datë 18.03.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 392/2026, datë 12.03.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “*Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete*”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcëve të publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka hartuar dhe publikuar shtojcat për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga verifikimi i së cilave konstatohet se ky i fundit ka modifikuar dhe publikuar ndryshimet në shtojcë sipas përcaktimeve të bëra në vendimin KPP Nr. Nr. 392/2026, datë 12.03.2026.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-77670-02-27-2026, me objekt “Blerje materiale hidraulike, tubo, pvc, pe, Corrogete”, me fond limit: 9,997,619 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.03.2026, nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

